



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 40-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 27.03.2025, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Nexhemdin Lekiqi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Majlinda Sylejmani, anëtare
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragaçina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Enver Kryeziu, anëtar
30. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Latif Ramadani, DBF
3. Elmaze Behluli, DA
4. Sead Aliu, DI
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Rexhep Rexhepi, DBP
7. Rasim Hasani, DKA
8. Safete Amerllahu, DGJK
9. Burim Rustemi, DSHPMSH
10. Imri Semetishti, DUPMM
11. Anila Reqica-Llugiqi, DKRS
12. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 39-të e Kuvendit.
2. Propozim Statuti i Qendrës për Punë Sociale në Lipjan.
3. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.
4. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares të Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.
5. Raporti Janar - Dhjetor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale. Me propozim të ekzekutivit dhe kërkesë të QPS-së, është kërkuar që të largohet nga rendi i ditës pika e 2-të Propozim Statuti i Qendrës për Punë Sociale në Lipjan me arsyetimin që është duke u hartuar një udhëzim i ri administrativ dhe të bëhet harmonizimi me statutin. KPF-ja, e ka rekomanduar, dhe pas propozimit Kryesuesi e hodhi në votim pikën e propozuar, pas votimit u konstatua se kuvendi me 26 vota për, aprovoi propozimin.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës me pikën e propozuar që të hiqet nga rendi i ditës dhe pas votimit u konstatua se me 26 vota për, u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se i kam dy kërkesa, e para është kërkesë e përsëritur, pasi që tash ka filluar të prishet shtëpia e vjetër e kulturës dhe të bëhet e reja, kam kërkesë që të bëhet një kënd përkujtimor për heroin Tahir Sinani pasi që e mban Shtëpia e Kulturës emrin e tij. Një biografi të shkurtër për jetën e tij. E dyta është ndërtuar një deponi ilegale në rrugën “ Mbreti Zog” dhe askush nuk ka marr asnjë veprim deri tani është në gjendje tmerruese.

Lulzim Rrustemi, tha se i kam dy kërkesa, e para të ketë një mundësi komunikimi me komunën e Graçanicës për rregullimin e çështjes së pronave të fshatrat Suhadoll, Skullan dhe fshatrat tjera ku janë afër 300 hektarë tokë, dhe mbesin të pa punuara. E dyta si po shkon marrëveshja për ujësjellësin e regjionit të Kraishtës, Bregu i Zi, Ribar i Madh pasi që ka mbet në gjysmë.

Alban Salihu, tha se në fillim të këtij muaji Instituti Atllas, kishte trajtuar problematiken e deponive në Kosovë nga aty u kuptua se Komuna e Lipjanit sipas Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, është komuna me numrin më të madh të deponive ilegale në Kosovë, ky fakt edhe pse na indinjon nuk na befason, pasi që unë dhe kolegët e tjerë me dhjetëra herë kemi ngritur shqetësimin për këtë çështje. Edhe shumë qytetar kanë reaguar dhe nuk është marr parasysh ankesa juaj. Ju a e keni parë këtë publikim dhe a po merreni me këtë? Çështja e dytë lidhet me çështjen e parë e për të cilën kemi reaguar disa herë po mungon vullneti për ta mënjanuar, gjendjen me mbeturina të kopshti i fëmijëve në Lipjan.

Herolind Kozhani, tha se kam disa çështje për ti ngritur, e para te shtegu i ecjes afër lumit Sitnica gjate verës është frekuentimi më i madh i qytetarëve dhe është mirë të shikohet mundësia të vendosen rrethoja rreth lumit Sitnica. Po ashtu edhe te rruga “ Bashkim Krasniqi” po vozitet me shpejtësi të madhe dhe ka kërkesë nga ana e banoreve për vendosje të policeve të shtrirë. Te rruga “Sali Rexha” banoret kërkojnë që të bëhet zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se çështja e parë që do ta ngris ka te bëjë me fshatin Sllovi rruga kryesore e cila fillon nga hyrja e fshatit deri te shkolla, një rrugë që i mungon shtresa e fundit qe disa vite, për shkak të mungesës se kësaj shtrese ka filluar të demolohet. Pasi që rruga është bërë e pa kalueshme. Çështja e dytë, kanë dale rezultatet përfundimtare për bursa dhe studentet tash më i kanë marr mjetet, mirëpo nga 400 bursa janë shpërndarë vetëm 323 dhe kane mbet një shumë e mjeteve rreth 35 mijë euro, kjo shumë të shkoj për të njëjtin qëllim për nxënësit e dalluar të shkollave fillore dhe të mesme. Tjetra, ne i kemi themeluar komitetet jo obligative ka qënë një hap shumë i mirë, mirëpo këto komitete përveç komitetit për Kulturë Rini

dhe Sport, nuk na kane sjell asnjë raport. Këto komitete nuk po funksionojë për shkak se nuk po paguhen mëditjet e anëtarëve, mirëpo nuk kanë të drejtë me i ndërpre mbledhjet. Kampion për dështim është Komiteti për Barazi gjinore i cili nuk ka mbajtur asnjë takim edhe pse si komitet unë shume e kam përkrahur. Por faj ka edhe kryesuesi i kuvendit i cili ka qëndruar indiferent.

Ardit Cani, tha se unë do ta ngris çështjen e deponive ilegale si parafolësit, ku një e tillë është bërë në fshatin Bainsë ku po binë mbeturina edhe nga vende tjera, dhe nuk ka asnjë shenjë që e ndalon hedhjen. Dhe nuk është pastruar asnjë herë aty. Kam pyetje për drejtorin e bujqësisë, deri ku ka shkuar zhavorrimi i rrugëve bujqësore dhe a janë përfshirë rrugicat e Bainsës. Për drejtorin e infrastrukturës kur pritet të filloj rregullimi i trotuarit në Bainsë dhe asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Resinoc.

Shahadije Dragaçina, tha se kam një kërkesë për një shqetësim, te rreth rrotullimi te Shtëpia e Kulturës ku po bëhet një kaos i qarkullimit si të veturave ashtu edhe të nxënësve që shkojnë në shkollë. E shpesh herë jemi dëshmitar që gati të ndodh edhe fatalitet. Kërkoj nga ana juaj që të bëhet një zgjidhje rreth kësaj çështje.

Rinor Murati, tha se kam një pyetje dhe një propozim, a keni ndonjë njoftim se kur pritet të përfundojnë punimet në hekurudhë. Propozimi është, meqë vitin e kaluar është bërë një vendim për financim të këshillave të fshatrave është mirë që edhe sivjet me i subvencionuar për punën e tyre, meqë parashihet dhe me rregullore.

Bashkim Budakova, tha se kam një propozim kërkesë për financimin e KV Skënderbeu në Kraishtë, pasi që renditet pjesën e sipërme të tabelës dhe ka një potencial për të ngritur një trofe. Ky klub ka gjendje të rëndë financiare dhe ka nevojë për ndihmë, ku kërkoj nga kuvendi përtej thirrjeve publike ti ndahet një shumë prej 10 mije euro këtij klubi sepse ka nevojë.

Gazmend Qerkini, tha se parafolësit ngritën disa çështje, edhe unë pajtohem me parafolësit që mos të hudhën mbeturina vend e pa vend. Unë e shfrytëzoj foltoren që me i lutë qytetarët e Lipjanit, që të mos hudhin mbeturinat vend e pa vend. Pasi secila familje është pajisur me kontejner.

Fadil Spahiu, tha se kam një pyetje, me një shqetësim që e kam ngritur edhe më herët për shpërndarjen e fletushkave nga rrjetet e marketeve ku fletushka ka gjithandej.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se qendra e kulturës apo qendra muntifunksionale është quajtur kështu sepse do të ketë dhe hapësirë për muze dhe

por edhe këndin ku do te vendoset një shtatore. Sa i përket mbeturinave dhe ambientit duhet të merren parasysh shume indikator jo vetëm të dhënat e një instituti, ka nevojë të bëhet më shumë dhe ka nevojë për ndërhyrje. Ne kemi pastruar çdo shtrat të lumit, kemi dërguar shportat e mbeturinave çdo familje. Dakordohem me parafolesin për një fushatë vëdijsuese. Sa i përket kanalizimit të fshatrat në territorin e Graçanicës nuk ka fare të bëjë me neve edhe pse ne ju kemi dërguar shkresë disa herë mirëpo nuk kanë shprehur interesim. Jemi të interesuar me participuar dhe me zgjedh problemin e atyre fshatrave edhe pse ai territor nuk është me neve. Ujësjiellësi në regjionin e Kraishtes jemi në pritje për me marr një prerje se çka është investuar dhe çka ka mbet pa u kryer. CDI ka heq dorë nga investimet nga futja e vendit tonë në sanksione. Shtrati i lumit Sitnica, të shtegu ka nevojë për rrethojë ta shohim mundësinë. Pengesat në rrugë ka shumë kërkesa, por e pa mundshme me i vendos në çdo vend dhe për aty duhet një komision profesional. Rruga Sllovi - Lipjan do të asfaltohet shumë shpejt si duket e keni parë njoftimin në rrjetet sociale. Sa i përket bursave kanë aplikuar 396 studentë, kanë marrë 323 studentë bursë, ne i kemi mbështetur të gjithë studentet që i kanë plotësuar kushtet po ashtu e kemi shtyrë afatin për aplikim me qëllim që të aplikojnë të gjithë. Me përjashtim të atyre që nuk i kanë plotësuar kushtet dhe që kanë përsërit vitin. Çështja e komiteteve më tepër është çështje e kuvendit por një pjesë të fajit e ka edhe ekzekutivi për shkak të mos pagesave por ne kemi tentuar disa herë mirëpo nuk po na lejon ligji. Trotuari në Bance është në procedurë të prokurimit do të filloj shpejt. Në Resinofc janë asfaltuar 95% të rrugicave janë mbet pak për shkak të problemave pronësore. Për punimet në hekurudhë nuk kam asnjë njoftim. Këshillat e fshatrave i kemi paguar vitin e kaluar do të marrim vendim edhe këtë vit. Te mbështetja e klubeve ne i kemi mbështet duke përfshirë edhe KV Skënderbeun, dhe ka rregullative ligjore me mbështet nuk mundemi ne si kuvend me mbështet. Do të vazhdojmë ta mbështesim aq sa kemi mundësi.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë nuk e kam parë postimin tuaj në facebook provova tani me këqyre po nuk po mundem me gjete. Pyetja ime është, deri sa të bëhet implementimi i komplet i projektit të mbyllen gropat e mëdha të cilat janë hapë. Çështje e bursave, nuk thash që ndonjë studenti nuk ju ka dhënë bursë, deri tani unë nuk kam marr ndonjë ankese. Unë pata një propozim që mjetet që kanë mbetë nga planifikimi i bursave që shkojnë për nxënësit e dalluar të shkollave të mesme dhe filllore dhe kjo do të motivonte nxënësit. A do të destinohen këto mjete prapë në DKA

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se në Sllovi nuk është rruga e pa kalueshme, kurrë skam pa kolonë aty, janë disa gropa sikurse janë disa rrugë tjera si ajo prej Lipjanit deri në QMI. Mjetet e vitit të kaluar nuk mund ti përfshijmë në këtë

vit, sepse deri me 31 mars nuk përfundon viti. Ato mjete mundemi mi bart në vitin ne vijim.

Alban Salihu, tha se është mirë me respektua radhën e diskutimit, sepse unë kesh në radhë me diskutuar. Edhe unë i bashkëngjitëm thirrjes për sensibilizim dhe vedijesim të qytetarëve që mbeturinat me i dërguar në vendet përkatëse. Por kjo nuk na ndalon as institucionet gjegjëse komunale me krye obligimin e vet. Mbeturinat te kopshti i fëmijëve janë qe disa vite.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 39-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth ekstraktit nga mbledhja e 39-të e Kuvendit.

Meqë nuk pati vërejte as plotësime Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 39-të e Kuvendit, pas votimit u konstatua se Kuvendi me, 26 vota për , aprovoi Ekstraktin e 39-të të Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi , Daut Azemi, ia dha fjalën Elmaze Behlulit drejtoreshë e DA e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se duke e parë punën dhe përkushtimin e punëtorëve të administratës, të cilët kane një gjendje shumë të ulët me paga dhe çfarë pune të madhe bëjnë. Ne e mbështesim këtë propozim vendim si grup i PDK-së.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se vitet e kaluara në kërkesën e sindikatës është cekë vendi se ku do të shkohet në pushime. Ndërsa këtë vit është cekur vetëm jashtë Kosovës, për cilin vend behet fjalë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit tha se në bazë të informatave që i kam unë pushimi do të jetë në Shqipëri ose në Maqedoni. Por kjo varet edhe nga çmimet.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares të Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, dhe 3 abstenim, aprovoi propozimin

IV

Raporti Janar - Dhjetor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Ahmetit, Kryetar i Komunës i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti Janar - Dhjetor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se progresi vit pas viti i komunës me te gjitha pengesat e vazhdueshme, është për tu vlerësuar lartë nga ne si qytetar për Kryetarin e Komunës me ekipin e tij. Si lipjanas e vlerësoj lart çdo progres ne të gjitha fushat falë punës se përkushtuar të Kryetarit arkitekt te Lipjanit.

Arsim Jashari, tha se një raport voluminoz unë jam ndal te dy tema te Zyra e Avokaturës dhe te sporti. Unë e di që komuna nuk ka kontratë kolektive me këto që po bëjnë ankesa, megjithatë komuna po ndëshkohet. Unë i kam nxjerr disa statistika ne vitin 2024 janë ta pranuar vetëm lende civile mbi 1200, përmbarimore mbi 370. Seanca të mbajtura afër 450, kjo po i bien qe avokati i komunës me shume rrinë ne Gjykatë se në zyrën e vetë. Këtu veç janë ka shkojnë duke u rritur lëndët, kësaj nëse ja shtojmë, shpenzimet për avokat dhe përfaqësues ligjor, për ekspertiza, për ekzekutim te vendimeve, kamata dhe çështje te tjera kjo ka një kosto shume të lartë dhe me këtë

po dëmtohen taksat tona. Edhe te sporti jemi ne vitin 2025 nuk mundemi me funksionua tu lyp ndihma prej komunës, këto duhet me ndryshuar statutin e vet, sepse nuk do te munden me mbijetuar. Është mirë disa klube me ndryshuar statusin sepse shtirë është me mbijetuar me ndihma.

Shahadije Dragaçina, tha se ne dëgjuam Kryetarin e Komunës se për çfarë krenohet dhe lavdërohet për punën e tij për vitin 2024, si vlerësime te rëndësishme i renditi parkingun nëntokësor, vazhdimin e sheshit dhe parkun në qytet. Së pari projektet e tilla janë te kushtueshme. Ajo që ka ndodh në Lipjan është tërësisht i pa nevojshëm dhe nuk i ka dhënë ndonjë pamje të bukur qytetit dhe nuk është bërë ndonjë zgjidhje, këtë nuk po e them vetëm unë por edhe qytetarët e Lipjanit. Ndërtimi i këtij nënkalimi është bërë sa me thënë që Lipjani ka nënkalim. Ndërtimi i këtij nënkalimi po i dëmton këmbësoret. Ky nënkalim nuk ka as siguri as asgjë. Po ashtu edhe parkingu nëntokësor nuk ju ka bërë zgjidhje qytetarëve. Ky investim është bërë sikur ta kishte Lipjani 50 milion euro buxhetin, ndërsa fshatrat kane mbetur anash për keqardhje, as një zgjidhje për ujë të pijes e ujëra te zeza.

Fitim Mëziu, tha se një raport voluminoz, ku ka gjera te cilat duhet ti kritikojmë por duhet edhe të krenohemi për arsye se ka progres ecje. Unë do te fokusohem te shëndetësia. 24 ore shërbimi paliativ, pas orës 22:00 duhet të paguhet orët shtesë. Shëndetësia në Kosovë është në krizë, është mirë këtë që janë ne asociacion ta ngrisin zërin që të fuqizohet Mjekësia Familjare që është obligim i komunave. Ne kemi me pas mungese të mjekëve pasi që po ka ikje të vazhdueshme. Produkti i punës janë mjeket, infermieret janë staf mbështetës.

Alban Salihu, tha se sot po e shqyrtojmë raportin e punës për vitin 2024. Lipjani gjatë vitin 2024 ka qenë pa qeverisje, për shkak se komuna ishte shndërruar në shtab elektorat të Lumir Abdixhikut. Viti 2024 ka qenë një vit i humbur sepse asnjë projekt nuk është bërë në të mirën e qytetarëve por në favor të LDK-së dhe Abdigjikut. Kryetari i Komunës kishte hequr dorë nga detyra e Kryetarit për ta ngritur LDK e Abdigjikun.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit tha nuk je në fushatë zgjedhore, ju lutem fokusohu në raport të punës, nëse ke rreth raportit diçka me diskutuar ose ua ndaloj fjalën. Sepse ka një rregullore të Kuvendit që duhet të respektohet. Dhe kërkoj nga ana juaj që ta respektoni rregulloren.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se, është mjeshtri me u ruajtë mos me i thënë fjalët që nuk qëndrojnë. Te kontrata kolektive ke të drejtë ma mirë me i paguar

komuna dhe mos me bërë shpenzimeve mos me shkua përmes gjykatës e përmbaruesve. Mirëpo ti bej dy sqarime, e para komunat nuk janë subjekt nënshkrues i kontratës, e dyta masat buxhetore të aprovuara në buxhet ne paga dhe mëditje janë të pa mjaftueshme me paguar këtë pjesë. Se te kategoria e punëtorëve është e kalkuluar paga. Dhe këto shpenzime nuk mundemi me i bërë sepse qeveria nuk po na lejon për ti kryer këto. Te sporti ne kemi mbështet klubet, mirëpo për ta ndryshuar statutin e tyre ne nuk jemi kompetent dhe ne nuk mund të ndërhyjmë. Ne ju kemi krijuar kushte këtyre klubeve. Unë kam formuar një komision për të parë gjendjen e stadioneve se sallave sportive. Te sheshi, njëra prej premtimeve të gjitha kandidatëve për Kryetar të Komunës ka qenë edhe ndërtimi i sheshit. Unë jam krenar, që sheshi, parkingu, stadiumi do ta mbaj emrin që Imri Ahmeti, ka qenë arkitekt i ati projekti. Unë synoj me i nderuar edhe dy parkingje në Lipjan sepse ka nevojë Lipjani për parkingje dhe për te mirën e qytetarëve. Kur e kemi shpall tenderin për objektin e komunës gjithçka u fol, por sot objekti i komune është bërë për të mirën e qytetarëve, po ashtu edhe QKM-ja, dhe Qendra e Kulturës, rrugët dhe shume projekte të tjera të cilat po mirëprehen nga qytetarët.

Lulzim Rustemi, tha se sa i përket raportit ne sa po e mbyllim një vit me plot sfida dhe progres, por ka edhe zhvillim edhe mos suksese. Por ka edhe pune jo cilësore dhe neglizhencë. Shpenzimi i buxhetit 97% . Te granti qeveritar mbi 200 mijë euro suficit. Te Shtëpia e Kulturës i kemi të shpenzuara të gjitha mjetet por nuk kemi Shtëpi të Kulturës. Shumë mjete na i ka marr thesari si te Shtëpia e Kulturës ashtu edhe te stadiumet. Në raport nuk mund të thuhet që janë përfunduar nënkalimi dhe parku, sepse ende janë duke u zhvilluar ato projekte. Ky vit vetëm me 10 mijë euro investim ne ujësjellës, një vlere shume e vogël. Trajtimi i ujerave te zeza zero investim, po ashtu edhe te kanalizimi nuk është me mirë. Të hyrat vetanake është tejkaluar, një e hyre e mirë. Te taksat ka një progres të mirë. Lipjani ka nevojë për punë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se te ekzekutimi i pagesave nga thesari i kemi diskutuar disa here, sepse komunat nuk janë nënshkruese të kontratës dhe ministritë nuk po e rrisin tavanin buxhetor dhe ja ka pamundësuar komunës me i realizuar këto. Mirëpo me sa kam unë informata punëtorët e komunës e kanë marr 30% të pagës jubilarë dhe i ka ekzekutuar komuna. Nëse është e vërtet kjo është bërë diskriminim sepse punëtorët e arsimit dhe shëndetësis i kanë marr përmes gjykatave. Te projekti i nënkalimit dhe parkut ka qenë nguti për prerje të shiritit nga ana juaj. Te shëndetësia ju keni premtuar që QMF ne Shalë dhe Gadime të behët 24 orë dhe qytetaret po presin të behet ajo, sepse ende nuk është bërë. Po ashtu në raport shkruhet që AMF ne Smallushe dhe Banullë nuk po funksionojnë sepse nuk ka pacient, unë nuk mendoj që

kjo është arsyeja. Komuna nuk duhet me mbet duarkryq edhe me gjet një mënyre me e funksionalizuar.

Ganimete Qeriqi, tha se orari që nuk është bërë nga 7 në 14 për mjekësinë familjare është shumë e mirë që nuk është bërë, sepse pas një kohe do të na ikin doktorët për shkak se po ju prin politika dhe nuk pranon asnjë mjek me krye fakultetin e me djeg politika. Sepse me këtë dikush po privilegjohe në QKMF dhe dikush po dënohet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se unë jam për me qenë në funksion shërbimi paliativ, por mjetë buxhetore ka vetëm për paga, për çdo pagese shtese nxjerr kosto te re. E dyta shërbimi paliativ është për raste te rënda për sëmundje me kancer e jo për një grip. Ky shërbim nuk ka qenë funksional ne e kemi funksionalizuar. Unë jam i interesuar me gjetë zgjidhje për pagesën e tyre, por nuk po kemi mundësi buxhetore. Jam i interesuar për QMF- në Shale dhe Gadime me e bërë 24 ore punë, por s'po na lejon niveli qendror. Për Shtëpi të Kulturës nuk është bërë asnjë pagesë kurr.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se për fund ua uroj festen e Fitër Bajramit të gjithë qytetarëve të komunës së Lipjanit.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:50.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi